Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Daqa shpk" të datës 22.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemi i ujitjes dhe ndërtimi i parkut në Kodrën e Trimave" me nr. të prokurimit 616-26-7531-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Daqa shpk" të datës 22.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemi i ujitjes dhe ndërtimi i parkut në Kodrën e Trimave" me nr. të prokurimit 616-26-7531-5-2-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Daqa shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 22.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sistemi i ujitjes dhe ndërtimi i parkut në Kodrën e Trimave" me nr. të prokurimit 616-26-7531-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1

AK ka përcaktuar në DT disa kërkesa të cilat jo vetëm që janë të paarsyeshme, por si të tilla nuk janë në përputhje as me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, as me nevojat e AK dhe nuk kanë asnjë rëndësi për realizimin me sukses të projektit.

Si shembull në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional te kërkesa nr. f) ka përcaktuar si në vijim:

f) Rrethoje per sigurimin e vendpunishtes me shenja trafiku dhe sinjalizues me drita led.

Fillimisht duhet cekur se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e një parku me lodra për fëmijë. Pra si fillim rrethoja nuk është fare e domosdoshme. Mirëpo edhe po të kërkohet vendosja e rrethojave, duhet të specifikohet saktë për sa metra të rrethojës po bëhet fjalë, për cilat shenja të trafikut referohet kërkesa, sa dhe ku dhe çfarë drita LED duhet të vendosen në këto rrethoja, etj. Pra kërkesa e formuluar totalisht gabim duke krijuar shumë paqartësi dhe mundësi të ndryshme të interpretimit. Si e tillë kjo kërkesë nuk është në përputhje me LPP dhe duhet të largohet nga DT ose në alternativë duhet të precizohet (plotësohet/ndryshohet) ashtu që të jetë e matshme dhe e kuptueshme për të gjithë OE potencial.

Pretendimi 2

P. 2.1. - Paramasa ka gabime dhe mangësi shumë të mëdha. Si fillim, pozicionet me nr. **11, 12.2, 13.1, 18.2, 19.2 dhe 21.1** nuk kanë fare as njësi dhe as sasi të paracaktuar. Tutje poz. me nr. **10.2.12, 16.1, 17.1 dhe 18.8** si njësi matëse e kanë "paushall" e cila nuk është fare njësi matëse. Ngjashëm edhe te poz. **10.2.1, 10.2.3 dhe 10.2.5** njësitë matëse janë "komp." dhe "Pcs" që nuk dihet se çfarë janë realisht. Si përfundim, është e pamundur të ofrohen çmimi për njësi për pozicionet e lartëcekura. Prandaj kërkojmë që AK të vendosë njësitë matëse të sakta edhe për këto pozicione.

P.2.2. - Tutje, te sit. 6.2 sipas fig. më poshtë, është kërkuar furnizimi dhe mbjellja e shkurreve të ndryshme mirëpo si njësi matëse është vendosur m2. Duhet sqaruar se shkurret janë bimë të cilat njësinë matëse e kanë "copën" dhe jo m2. Dallimi qëndron te fakti se nuk mund të përcaktohet sa shkurre janë të barazvlefshme me 1m2. Kjo është njësoj sikurse te një kontratë për furnizim me ujë të pijes, të mos kërkohet sasia në copë ose në litër por në metër katror. Pra është absolutisht e palogjikshme prandaj edhe e paligjshme. Sipas këtij situacioni të paramasës po i bjen që AK ka kërkuar 998 m2 shkurre të llojeve të ndryshme. Mirëpo AK nuk e ka sqaruar raportin në mes të shkurres si copë dhe m2 që e ka vendosur si njësi matëse. Për këto arsye kërkojmë që AK të përcaktojë njësinë matëse si copë dhe jo si m2 (nëse e sheh të nevojshme mund të ndryshojë edhe sasinë) në të kundërtën përcaktimi i çmimit për njësi do të jetë i pamundur.

6.2	Fumizmi dhe mbjellja e shkurreve				
6.2.1	Juniperis horizontalis	m2	44.00		€ 0.00
6.2.2	Berberis ottowensis	m2	2.40		€ 0.00
3.1.5	Forsynthia	m2	4.20		€ 0.00
3.1.5	Spirea biliardi	m2	4.00		€ 0.00
3.1.4	Taxus Baccata	m2	17.00		€0.00
3.1.5	Thymus serpyllum	m2	3.00		€0.00
3.1.5	Buxus serpervirens	m2	70.80		€0.00
		Total			€ -
6.3	Mbjellja e barit	m2	998.00		€0.00
		Total			€ -

P. 2.3. – Te sit. 9 poz. 9.1. AK ka kërkuar si në vijim:


HAPËSIRA PËR LOJËRA TË FËMIJËVE	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi	
Strultura e kombinuar e lodrave për fëmijë sipas detalit të dhënë e cila përfshinë: Luhatëse, ekuilibruese, kacavjerrëse, ulëse etj.	copë	1		€
	Total	€		

PARAMASA DHE PARALLOGARIA- **ELEKTR**

PUNËT NDËRTIMORE NË GËRMIME DHE BETONIME	Njësia	Sasia	Çmimi/njësi

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Problemi te ky pozicion qëndron te fakti se teksti në pozicion i referohet detalit të projektit dhe njëkohësisht kërkon luhatëse, ekuilibër, kacavjerrëse, ulëse etj. Në anën tjetër përshkrimi i pozicionit nuk përputhet me detalin e prezantuar nga AK.
Detaji i prezantuar nga AK duket si në vijim:



Në detal nuk ka askund as luhatëse, as ekuilibër, as kacavjerrëse dhe as ulëse. Në detal është paraqitur vetëm një kompleks i lodrave "Climbing" me litar dhe një topogan (rrëshqitëse). Prandaj për të mos krijuar paqartësi nëse çmimi për njësi duhet të ofrohet sipas paramasës apo sipas detajit (të cilat nuk përputhen mes vete edhe pse paramasa i referohet detalit), kërkojmë nga AK që të ndryshoj kërkesën sipas poz. 9.1 duke larguar fjalët "luhatëse, ekuilibruese, luhatëse, ulëse, etj" dhe duke lënë vetëm pjesën tjetër të kërkesës për strukturën e kombinuar të lodrave sipas detalit.

Lidhur me pretendimet ankimore, AK ka gjetur si vijon:

Pretendimi 1 është i pabazuar. Rrethoja për sigurimin e vendpunishtes me shenja trafiku dhe sinjalizues është kërkesë e domosdoshme. Punishtja duhet të jetë e siguruar me rrethojë. Në rrethojë duhet të vendosen shenjat përkatëse të trafikut dhe sinjalizimit për vendpunishte. Njëkohësisht rrethoja duhet të ketë edhe ndricim të mjaftueshëm me drita led në rast se do të zhvillohen punime gjatë mbrëmbjes. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për llojin e shenjave dhe llojin e dritave LED, përderisa në kërkesën e DT nuk specifikohet lloji, mjafton që të prezantohet rrethoja me cfarëdo drite LED dhe shenjat e trafikut që janë të përshtatshme për një vendpunishte si dhe sinjalizimin për vendpunishte. Sa i përket gjatësisë së rrethojës, lartësisë së saj dhe dimensioneve tjera, përderisa as ky detaj nuk është prezantuar në kërkesën e DT atëherë mjafton që rrethoja të mund të mbuloj komplet punishten në të cilën OE do të zhvilloj punime.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimi 2 është i bazuar. AK do të korrigjoj paramasën. Lidhur me pretendimin 2.1 do të përcaktojë sasitë dhe njësitë e sakta për pozicionet me nr. 11, 12.2, 13.1, 18.2, 19.2, 21.1, 10.2.12, 16.1, 17.1, 18.8, 10.2.1, 10.2.3 dhe 10.2.5 të paramasës. Lidhur me pretendimin 2.2 do të precizohet njësia matëse nga m^2 në copë. Lidhur me pretendimin 2.3 do të riformulohet kërkesa e DT si vijon "Struktura e kombinuar e lodrave për fëmijë sipas detalit të dhënë".

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net